



SHERBIMI SOCIAL

## #NËNTORI I 16 DITËVE TË AKTIVIZIMIT KUNDËR DHUNËS

Nëntori është Muaji i Ndërgjegjësimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore. Pabarazia gjinore, normat diskriminuese dhe stereotipet gjinore janë pengesat më të mëdha në ç'rrënjosjen e këtij fenomeni.

Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore janë organizuar rreth 100 aktivitete ndërgjegjësuese mbi fenomenin e dhunës tek nxënësit e shkollave 9-vjeçare, të mesme dhe studentët në të gjithë Shqipërinë. Këto aktivitete mbështesin gratë dhe vajzat që ia kanë dalë t'i mbijetojnë dhunës dhe përpiqen t'i japin fund kulturës së heshtjes kundrejt dhunës së përjetuar.



## #RIINTEGRIMI NË SHOQËRI MBETET PRIORITETI I PUNËS SONË



Nëntori ka nisur me raste suksesi në Qendrën e Zhvillimit Durrës. Kemi realizuar me sukses riintegrimin në familje të një prej përfitueseve të Qendrës së Zhvillimit Durrës. Dorina ka përfituar shërbim psiko-social dhe shëndetësor në qendër për rreth 7 vjet, ndërsa tashmë ajo është ribashkuar me familjen e saj biologjike.

Riintegrimi në familje dhe shoqëri është prioritet në të gjitha institucionet tona të përkujdesit.

## #DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Në vijimësi të zbatimit të Planit të Kontrollit 2018, Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka realizuar kontroll dhe vizita në familje në qarkun Berat lidhur me zbatimin e legjislacionit për Ndhmën Ekonomike.





**SHERBIMI SOCIAL**

## #DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE




Përgjatë muajit Nëntor, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 22 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar. Është vlerësuar dokumentacioni për 4 fëmijë dhe është kryer 1 transferim. 2 fëmijë me AK janë sistemuar në institucion.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 26 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 13 të moshuar dhe 1 është transferuar.

Janë shqyrtuar dokumentacionet e 50 aplikantëve për Statusin e Jetimit. Kanë përfituar këtë status për herë të parë 3 persona dhe janë rinovuar 44 libreta. Gjithashtu janë menaxhuar 2 raste të VT/VMT.

## #SHËRBIM I PLOTË OKULISTIK PËR TË GJITHË PËRFITUESIT E QENDRAVE TONA TË PËRKUJDESIT SHOQËROR



Institucionet e Përkujdesit Shoqëror ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh socio-shëndetësore. Shërbimi i plotë okulistik falas, pas Shtëpive të Gjyshërve, është ndalur pranë vogëlushëve të familjes sonë të madhe.

Gjatë muajit Nëntor janë realizuar vizita okulistike dhe syze falas për të gjithë fëmijët që kishin nevojë pranë Shtëpive të Fëmijës.